

 KOMUNA SKENDERAJ ÒPSTINA SKENDERAJ Ndërmarrja Publike Lokale Leksione Javore Produzuese NPL "Eko Natyra" SH.A. UP "Eko Natyra" A.D. 			
Data: Pranosi Derguar: <u>31 / 10 / 2024</u> Skenderaj Titulli: Prirjeje/Disiplinim			
Njësia Orig. Org. Jeshin	Shif. Klas. Klas. nr. 1	Nr. Post. Br. Post.	Nr.faqeve Br. Stanion
001	001	153/2024	008

RREGULLORE E PUNËS SË BORDIT TË DREJTORËVE TË NPL "EKO NATYRA" SH.A, SKËNDERAJ

SKËNDERAJ, 2024

Bazuar në nenin 34 të Ligjit Nr.03/L-087, si dhe Plotësim Ndryshimi Nr.04/L-111 për Ndërmarrjet Publike, nenin 130 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare Nr.06/L-016, si dhe në nenin 7.2 të Statutit të Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko Natyra" Sh.A, Skënderaj, lidhur me punën e Bordit të Drejtorëve, me qëllim të sigurimit të kushteve për kryerjen normale të aktiviteteve dhe funksionit të punës së anëtarëve të tij, Bordi i Drejtorëve në mledhjen e mbajtur me datë 25.10.2024, e miratoi këtë:

RREGULLORE E PUNËS SË BORDIT TË DREJTORËVE TË NPL "EKO NATYRA", SH.A, SKËNDERAJ

Neni 1

Parimet themelore

1. Zbatimi i kësaj Rregulloreje nga ana e Drejtorëve është unike për të gjithë drejtorët jo ekzekutiv të NPL-së.
2. Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve është përgjegjës të mbikqyrë drejtëpërdrejtë zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje.
3. Drejtorët e Bordit të Drejtorëve duhet të udhëheqen nga parimet e paanshmërisë, profesionalizmit, objektivitetit, barazisë, konfidencialitetit dhe transparencës së brendshme gjatë ushtrimit të aktiviteteve të tyre.

Neni 2

Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është që të krijohen kushte optimale në funksionim të punës, të sigurojë një prezencë dhe afërsi më të madhe të Bordit të Drejtorëve me Zyrtarët e Ndërmarrjes, si dhe funksionimin e zakonshëm të aktivitetit të Drejtorëve që janë anëtarë të Bordit, në ushtrimin e detyrave përfshirë këtu edhe punën e Komisioneve të Përkohshme.

Neni 3

Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore i'u referohet të gjithë anëtarëve të Bordit të Drejtorëve.

Neni 4

Zgjedhja dhe mandati i Drejtorëve të NP Lokale

1. Bordi i Drejtorëve të një NP Lokale do të përbëhet nga pesë (5) drejtorë.
2. Katër (4) drejtorë zgjedhen në një mbledhje të aksionarëve në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare; dhe secili ka mandat prej tri (3) viteve. Komisioni Komunal i Aksionarëve e përfaqëson komunën në këtë mbledhje dhe i ushtron të drejtat e votimit të komunës në përputhje me nenin 5.2 të Ligjit për Ndermarrje Publike. Drejtori tjetër është KE i NP-së i cili zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve të NP-së në përputhje me nenin 21 të Ligjit për Ndermarrje Publike.
3. Bordi i drejtorëve të një NP Lokale, menjëherë pas zgjedhjes, do të zgjedhë njërin nga anëtarët e tij për të shërbyer si kryesues. Përveç anëtarit i cili shërben si KE i NP-së Lokale, asnjë anëtar i Bordit të Drejtorëve të një NP Lokale nuk do të ketë kompetenca ekzekutive. KE nuk mund të shërbejë si kryesues ose ushtrues detyre i kryesuesit të Bordit të Drejtorëve.

Neni 5

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve

1. Bordi i Drejtorëve mund ta zgjedhë kryesuesin e tij me shumicë votash të të gjithë drejtorëve, dhe Bordi i Drejtorëve mund të shkarkojë dhe zëvendësojë kryesuesin në çdo kohë me shumicë votash.
2. Kryesuesi kryeson të gjitha mbledhjet e Bordit dhe kuvendet e aksionarëve dhe është përgjegjës për mbajtjen e të gjitha procesverbaleve nga të gjitha mbledhjet e Bordit. Nëse kryesuesi nuk është zgjedhur ose nuk është i pranishëm në mbledhjen e Bordit ose kuvendet e aksionarëve, atëherë një drejtor i zgjedhur me shumicë votash të drejtorëve të pranishëm shërben si kryesues i mbledhjes ose kuvendit në fjalë.
3. Në një Shoqëri Aksionare kryesuesi i Bordit të Drejtorëve nuk mund të jetë njëkohësisht edhe Drejtor Menaxhues.

Neni 6

Dorëheqja e Drejtorëve

1. Drejtori mund të jap dorëheqje në çdo kohë, përmes dërgimit të një njoftimi me shkrim Bordit të Drejtorëve ose kryesuesit të tij. Dorëheqja hyn në fuqi kur dorëzohet njoftimi, përveç nëse njoftimi përcakton ndonjë datë tjetër në të ardhmen. Vendi i zbrazët mund të plotësohet para datës së hyrjes në fuqi të dorëheqjes, por pasardhësi nuk mund të marrë detyrën para datës kur do të hyjë në fuqi dorëheqja.

Neni 7

Shkarkimi i Drejtorëve

1. Një ose më shumë drejtorë të Shoqërisë Aksionare mund të shkarkohen në kuvendin e aksionarëve, me ose pa arsye të theksuar, me shumicë votash të aksioneve të cilat kanë pasur të drejtë të votojnë përzgjedhjen e drejtorëve, përveç se:

1.1. asnjë drejtor nuk mund të shkarkohet në kuvendin e aksionarëve përveç nëse në njoftimin për mbajtjen e kuvendit theksohet se njëri ndër qëllimet e këtij kuvendi është edhe votimi për shkarkimin e këtij drejtori;

1.2. në rast se Shoqëria Aksionare ka votim kumulativ, nëse më pak se i tërë Bordi i Drejtorëve duhet të shkarkohet, asnjë drejtor nuk mund të shkarkohet nëse votat për shkarkimin e tij kanë qenë të mjaftueshme për ta zgjedhur atë në rast të votimit komulativ për zgjedhjen e të tërë Bordit të Drejtorëve.

2. Shkarkimi i një drejtori, vetvetiu nuk e paragjykon ndonjë të drejtë për kompensim apo kompensimin e dëmit pas shkarkimit, të cilën drejtori mund ta ketë në bazë të kontratës së tij me Shoqërinë Aksionare apo sipas ligjit për punën. Sidoqoftë, zgjedhja ose pozita e një personi si drejtor, vetvetiu, nuk krijon të drejta të këtilla

Neni 8

Plotësimi i Vendeve të Zbrazëta në Bordin e Drejtorëve

1. Vendet e zbrazëta në Bordin e Drejtorëve duhet të plotësohen me zgjedhjen në kuvendin e ardhshëm të aksionarëve në të cilën duhet të zgjidhen drejtorët. Statuti i Shoqërisë Aksionare mund të parasheh që Bordi i Drejtorëve të mund të zgjedhë dikë ta plotësojë këtë vend të zbrazët deri në kuvendin e aksionarëve.

Neni 9

Mbikqyrja nga Bordi i Drejtorëve

1. Bordi i Drejtorëve të NP-së do të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigorozë, në veçanti, të veprimtarisë së zyrtarëve të NP-së.

2. Nëse performanca e NP-së devijon nga caqet e përcaktuara në Planin e Biznesit për vitin përkatës financiar, Bordi i Drejtorëve do të kërkojë një raport nga KE i

shpjegon arsyet për performancën e dobët, dhe do të marrë të gjitha masat e duhura korrigjuese.

3. Sido që të jetë, nëse NP dështon në arritjen e caqeve të saj të performancës për dy vite financiare radhazi, Bordi i Drejtorëve është i detyruar të marrë parasysh shkarkimin dhe zëvendësimin e KE-së. Ky veprim mund të ndërmerret edhe në mungesë të provave bindëse të neglizhencës, përveç nëse Bordi i Drejtorëve konstaton se performanca e dobët ka ndodhur kryesisht për shkak të rrethanave ose ngjarjeve negative të paparashikueshme. Bordi i Drejtorëve do t'ia raportojnë çdo vendim të marrë në bazë të këtij Neni, dhe arsyet për marrjen e këtij vendimi: (i) Qeverisë, për NP-të Qendrore, ose (ii) Kuvendit(eve) përkatës Komunal, për NP-të Lokale.

Neni 10

Mbledhja e Bordit / marrja e vendimeve

- 1.** Mbledhjen e Bordit e udhëheq Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve duke vepruar arsyeshëm dhe në pajtueshmëri me Ligjin dhe Statutin e NPL "Eko Natyra".
 - 1.1.** kryesuesi e përcakton kuorumin për mbajtjen e takimit, e drejton debatin, e përcakton si dhe deklaron rezultatet e votimit gjatë mbledhjes.
 - 1.2.** kryesuesi i Bordit, në rast të mungesës së Sekretarit do të mbajë vet procesverbalin ose do të autorizoj ndonjë prej Drejtorëve të Bordit ose personin tjetër për mbajtje të procesverbalit.
- 2.** Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve mbahen në mënyrë valide me prezencën e shumicës së Drejtorëve/anëtarëve të Bordit dhe duhet të veprojnë me votën pohuese/aprovuese të shumicës së Drejtorëve pjesëmarrës në mbledhje.
- 3.** Drejtorët të cilët abstenojnë nga votimi dhe drejtorët që kanë shpalosur konflikt interesi, nuk do të përfshihen në numërimin në lidhje me shumicën.
- 4.** Nëse për shkak të boshllëkut, numri i Drejtorëve është më i vogël se numri i vendosur në kuorum, Drejtorët e mbetur (ose Drejtori) mund të veprojnë vetëm për qëllim të thirrjes së Mbledhjes së Përgjithshme për plotësimin e vendeve të lira.
- 5.** Mbledhja e Bordit të Drejtorëve mund të mbahet në më shumë se një lokacion, me lidhje të dyanshme përmes zërit apo video-konferencës, përderisa kërkesat e parashtruara janë përmbushur dhe arsyetuar në procesverbal, udhëheqësi i mbledhjes duhet të jetë në gjendje të përcaktoj identitetin dhe të drejtën e pjesëmarrjes së atyre që janë prezent në mbledhje, do të udhëheq mbledhjen dhe do të konstatojë dhe deklarojë rezultatet e votimit.

Neni 11

Procesverballi nga Mbledhjet e Bordit

1. Procesverbali i secilës mbledhje të Bordit të Drejtorëve ose e cilitdo komision, duhet të mbahet gjatë mbledhjes. Procesverbali formal me shkrim duhet të përgatitet jo më shumë se tri (3) ditë pas mbledhjes. Procesverbali përfshin:

1.1. kohën dhe vendin e mbledhjes;

1.2. personat e pranishëm dhe agjendën e mbledhjes;

1.3. çështjet e hedhura në votim;

1.4. detajet e diskutimeve dhe arsyet e dhëna për çfarëdo vote negative ose abstenimi;

1.5. rezultatet e secilit votim, duke përfshirë emrin e secilit person që ka qenë i pranishëm dhe ka pasur të drejtë vote dhe një indikacion të asaj se si ky person ka votuar; dhe

1.6. vendimet e miratuara në mbledhje.

2. Procesverbali formal me shkrim do të nënshkruhet nga drejtori që e ka kryesuar mbledhjen dhe nga personi që ka shërbyer si sekretar në mbledhje.

Neni 12

Kuorumi dhe Votimi për aktivitetet e Bordit

1. Shumica e numrit të përgjithshëm të drejtorëve të caktuar me statutin e Shoqërisë Aksionare apo rregullore e përbën kuorumin për vendimmarrje përveç nëse me statut apo rregullore është përcaktuar numër më i madh për kuorum.

2. Veprimet e ndërmarra nga shumica e drejtorëve të cilët janë të pranishëm në mbledhjen e Bordit në të cilën ekziston kuorumi do të konsiderohen veprime të Bordit të Drejtorëve, përveç nëse me statutin ose rregulloren kërkohet një numër më i madh i drejtorëve.

Neni 13

Veprimet e Bordit pa Mbajtjen e Mbledhjes

1. Përveç nëse me statut ose rregullore të Shoqërisë Aksionare kërkohet që një veprim i Bordit të ndërmerret ekskluzivisht në mbledhje të Bordit të Drejtorëve, të gjitha veprimet të cilat mund të ndërmerren në mbledhjet e Bordit të Drejtorëve mund tëvndërmerren edhe pa mbajtjen e mbledhjes nëse të gjithë drejtorët me të drejtë vote për veprimin përkatës japin pëlqimin e tyre me shkrim dhe të nënshkruar.

2. Pëlqimi me shkrim mund të jepet në dokumente të veçanta që nënshkruhen nga secili drejtor dhe që përmbajnë një shpjegim të veprimit përkatës ose një dokument

mund të ketë nënshkrimin e dy ose më shumë drejtorëve. Të gjitha këto pëlqime duhet të vendosen në procesverbalin nga mbledhja e Bordit të Drejtorëve të Shoqërisë Aksionare. Pëlqimi hyn në fuqi pasi nënshkrimit nga të gjithë drejtorët, përveç nëse në pëlqim është caktuar një datë tjetër e hyrjes në fuqi.

Neni 14

Komisionet e Bordit

1. Statuti ose rregulloret mund të përcaktojnë, ose drejtorët mund të miratojnë një vendim që themelon një ose më shumë komisione, që do të shqyrtojë, hulumtojë, rekomandojë ose të marrë masa të tjera jo-obligative e që janë në kuadër të kompetencës së Bordit të Drejtorëve.
2. Këto komisione mund të përfshijnë vetëm anëtarët e Bordit të Drejtorëve, por komisioni është i lirë të ftojë punëtorët e Shoqërisë Aksionare si dhe persona jashtë Shoqërisë Aksionare për të marrë pjesë pa të drejtë vote. Përveç nëse statuti, rregulloret ose vendimi i Bordit kërkojnë një numër më të madh, shumica e anëtarëve të komisionit e përbëjnë kuorumin dhe shumica e kuorunit është e nevojshme për çdo rekomandim ose veprim tjetër të komisionit. Të gjitha vendimet dhe veprimet e tjera të komisionit i nënshtrohen rishikimit, ndryshimit dhe miratimit me jo më pak se dy të tretat (2/3) e anëtarëve të Bordit.

Neni 15

Kompetencat e Bordit të Drejtorëve

1. Kompetencat e Bordit të Drejtorëve përfshijnë marrjen e vendimeve mbi të gjitha çështjet përveç vendimeve të cilat u janë rezervuar aksionarëve me ligj ose me statutin e Shoqërisë Aksionare. Duke marrë parasysh rezervimet e lartpërmendura, çështjet në vijim që bien nën fushëveprimin e Bordit të Drejtorëve
 - 1.1. miratimi i planeve gjithëpërfshirëse afariste strategjike të Shoqërisë Aksionare, kontrollet e brendshme, auditimin, si dhe procedurat e menaxhimit të riskut;
 - 1.2. thirrja e kuvendeve vjetore dhe të jashtëzakonshme të aksionarëve;
 - 1.3. përgatitja e agjendës fillestare të kuvendit të aksionarëve;
 - 1.4. përcaktimi i datës për listën e aksionarëve që kanë të drejtë të marrin pjesë në kuvendin e aksionarëve;
 - 1.5. emetimi i aksioneve brenda kufizimeve të përcaktuara në statutin e Shoqërisë Aksionare apo në vendimet e aksionarëve për secilin lloj dhe kategori të aksionit, kur autorizimi në fjalë i është dhënë Bordit të Drejtorëve me statutin e Shoqërisë Aksionare apo me vendim të aksionarëve;

- 1.6. emetimi i bondeve, mundësive për blerjen e aksioneve dhe letrave tjera me vlerë, kur ajo kompetencë i është dhënë Bordit të Drejtorëve me Statut të Shoqërisë Aksionare apo me vendim të Aksionarëve;
- 1.7. punësimi i zyrtarëve/menaxherëve të lartë të Shoqërisë Aksionare dhe miratimi i kushteve të marrëveshjeve ndërmjet menaxhmentit të lartë dhe Shoqërisë Aksionare;
- 1.8. vendosja e kompensimit dhe kushtet tjera të marrëveshjes me auditorin e Shoqërisë Aksionare;
- 1.9. përcaktimin e shumave dhe caktimin e datave të pagesës dhe procedurat për pagesën e dividendave;
- 1.10. miratimi i raportit vjetor të Shoqërisë Aksionare, raportit të bilancit vjetor dhe vlerësimeve vjetore të fitimeve dhe të humbjeve të cilat pastaj do të dorëzohen tek aksionarët për miratim; dhe
- 1.11. nëse Shoqëria Aksionare ka arritur kufijtë e përcaktuar me ligjin në fuqi për raportimin financiar, Bordi i Drejtorëve angazhon auditor të jashtëm për të kryer auditimin e jashtëm të deklarates financiare vjetore si dhe të librave e regjistrave të Shoqërisë Aksionare, si dhe raporti i auditimit i bashkëngjitet raportit vjetor të Shoqërisë Aksionare; si dhe
- 1.12. vendosja e të gjitha çështjeve tjera të cilat kanë të bëjnë me kompetencën ekskluzive të Bordit të Drejtorëve të përcaktuar në statutin e Shoqërisë Aksionare.
2. Çështjet që janë në kompetencën ekskluzive të Bordit të drejtorëve të Shoqërisë Aksionare nuk mund të barten ose të vendosen nga personat tjerë ose organet tjera të Shoqërisë Aksionare.

Neni 16

Përfaqësimi i NPL "Eko Natyra" Sh.A, Skënderaj, nga Bordi i Drejtorëve

1. Me qëllim të sigurimit të funksionimit normal të Ndërmarrjes dhe në rastet e caktuara kur tregohet e arsyeshme dhe ekonomikisht e justifikueshme, Bordi mund të vendosë që anëtarët e Bordit të organizojnë udhëtime brenda dhe jashtë vendit, në organizime të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare si përfaqësues të Ndërmarrjes.
2. Procedura e miratimit të udhëtimit zyrtarë dhe përcaktimi i anëtarëve të cilët do të udhëtojnë, bëhet sipas vendimit të Kryesuesit.
 - 2.1. gjatë udhëtimeve zyrtare, anëtarët e Bordit duhet që të përmbahen dhe të veprojnë në kuadër të autorizimeve të veta, duke mos interferuar me përfaqësimin e Ndërmarrjes, që është i rezervuar ekskluzivisht për Kryeshefin Ekzekutiv.
3. Drejtorët e Bordit kanë të drejtë në shpenzime të reprezentacionit me lejen dhe aprovimin paraprak të Kryesuesit të Bordit.

4. Për destinacionin e paraparë në par.1 të këtij neni, Ndërmarrja do të dedikojë një buxhet të caktuar në buxhetin e vitit vijues, në qendrën e shpenzimeve të zyrës së KE-së.

4.1. për periudhën fillestare, do të shfrytëzohen mjetet ekzistuese buxhetore nga zyra e KE-së.

5. Në të gjitha rastet kur takimet apo organizimet e ngjajshme zyrtare mbahen në ndërtesën e Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko Natyra", Sh.A, Skënderaj, shpenzimet ditore mbulohen nga buxheti i Kryeshefit Ekzekutiv të Ndërmarrjes.

6. Të gjitha shpenzimet të cilat janë krijuar nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve dhe Anëtarët e Bordit të Drejtorëve si në par.1 dhe par.2 të këtij neni, ose shpenzime tjera të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve me rezoluta të posaçme, vërtetohen, verifikohen dhe aprovohen nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve dhe si të tilla duhet të ekzekutohen nga Departamenti i Financave të Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko Natyra", Sh.A, Skënderaj.

Neni 17

Zbatimi


Të gjithë anëtarët e Bordit të Drejtorëve janë të obliguar për zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje që nga data e hyrjes në fuqi.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore u shqyrtua dhe u miratua në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të NPL "Eko Natyra" Sh.A, Skënderaj, të mbajtur me datë 25.10.2024, dhe ka efekt veprimi nga data e aprovimit.

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve


z.Albert Ismajli